

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 7527 Rep.

Nr. 520 Kol.



AKT THEMELIMI

Ne Tirane, sot me date 04 Dhjetor 2006, perpara meje noteres Artemisa Meçaj, anetare e dhomes se notereve Tirane, u paraqit personalisht, shtetasi :

1. Ilir Zeka, i biri i Veledinit, lindur me Vlore me 13 Maj 1952 dhe banues ne Lagjen Nr.8, Njesia Bashkiake Nr.5 , Rr. "Abdyl Frasheri", Pall.16, Shk.2, Ap.15 Tirane, me pasaporte Nr.Z 0775237, i cili me cilesine e ortakut themelues me kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi, nepemjet te cilit deklaroi se me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare ", ne ligjin nr. 7667 date 28.01.1993, " Per regjistrin tregtar", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, " *Hundai Auto Albania* " shpk

KREUI

Neni 1

Krijimi

Shoqeria " *Hundai Auto Albania* " shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në gjykatën kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria " *Hundai Auto Albania* " shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku I vetem-që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Shqiperi, ne adrese Lagjen Nr.8, Njesia Bashkiake Nr.5 , Rr. "Abdyl Frasheri", Pall.16, Shk.2, Ap.15 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Ilir Zeka

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Ngritja e nje aktiviteti tregtar e sherbimesh riparimi per perfaqesimin Ekskluziv te firmes HUNDAI " ne Shqiperi.

Importimit te automjeteve te markes HYUNDAI dhe te gjitha markave te tjera.

Shitjes me shumice e pakice te automjeteve te markes "HYUNDAI" si dhe te gjitha markave te tjera.

Organizimit te sherbimit te servisit universal per te gjitha markat e automjeteve Shitjes me shumice e pakice te pjeseve te kembimit, nyjeve, agregateve te automjeteve te te gjitha markave.

Kryerjes se servisit universal per te gjitha llojet e automjeteve te firmes "HYUNDAI" apo dhe te markave te tjera.

Kryerjes te te gjitha sherbimeve te tjera ndihmese e te nevojshme qe plotesojne kryerjen e aktivitetit ne fjale dhe qe nuk bien ndesh me ligjet shqiptare ne fuqi.

Qiradhenie e automjeteve te te gjitha llojeve; Ngritja e rrjetit te qiradhenies se automjeteve ne te gjitha territorin e Republikes se Shqiperise; Dhenia e automjeteve te te gjitha llojeve me qira financiare (leasing). Ofrim sherbim taksie.

Import-Export te produkteve gjithfareshi (paisje elektro-shtepiake, produkte elektrike,.....e te tjera), *te lejuara nga ligji per shpik te*

Organizimin e nje rrjeti njesish tregetare dhe riparuese te cilat do ushtrojne veprimtarine e tyre ne perputhje me veprimtarine kryesore, ne emer dhe per llogari te "HYUNDAI AUTO ALBANIA" SHPK.

Organizimin e panairove dhe ekspozitave per paraqitjen e automjeteve te te gjitha markave, berjen e publicitetit tregtar si dhe ruajtjen e ekskluzivitetit tregtar ne territorin e Republikes se Shqiperise te Grupit "HYUNDAI", ne bashkepunim te ngushte e ne perputhje te plote me kerkesat e tij.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqipetar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 lekë dhe eshte i ndare ne 100 pjesë të barabarta, vlere nominale e të cilave eshte 1000 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqerise perkatesisht :

Ilir ZEKA kuota me vlere te pergjithshme 100.000 Leke, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ilir Zeke

[Signature]

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;



Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të Vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i Vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori,

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaku i vetem.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Zyres se Regjistrimit Tregtar per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

Administratore e shoqerise eshte znj. Z. Etleva LARO, e bija e Minait dhe e Antigonas, e dtl. 12 Korrik 1978, lindur ne Fier dhe banuese ne Tirane, Bulevardi " Zhan D' Ark ", Pallati i ri mbas ATSH - se, mandati i te ciles eshte 3 vjet.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.

Ilir Leka

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët ~~ë~~ dinin që akti i

administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injorin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktonte në çfarëdoqë forme qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përkrahimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar sic mund të jete :

Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimës të metejshëm të veprimtarisë së saj. Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji " Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare"

c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nën nga Ortaku

Ilir Leka

themelues i shoqërisë tregtare "Hundai Auto Albania" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale, autenticiteti i të cilit vërtetohet nga një Noteri.

ORTAKU

Ilir ZEKA

Ilir Zeka

NOTERE

NOTERE
ARTEMISA MECAJ

Registruar nr 79
258607
ARTEMISA MECAJ



STATUT I SHOQERISE
"Hundai Auto Albania " SHPK

Me cilesine e ortakut themelues :

Z. Ilir Zeka, i biri i Veledinit, lindur me Vlore me 13 Maj 1952 dhe banues ne Lagjen Nr.8, Njesia Bashkiake Nr.5 , Rr. "Abdyl Frasheri", Pall.16, Shk.2, Ap.15 Tirane, me pasaporte Nr.Z 0775237,

me vullnet të lire të plote e të singerte, mbeshtetur :

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

Ne ligjin 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare ",

Ne ligjin nr. 7667 date 28.01.1993, " Per regjistrin tregtar", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, ka themeluar nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Hundai Auto Albania" shpk (me poshte e quajtur "Shoqeria ")

KREUI

Neni 1

Krijimi

Shoqeria " Hundai Auto Albania " shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në gjykatën kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqeria " Hundai Auto Albania " shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut I vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Shqiperi, ne adrese Lagjen Nr.8, Njesia Bashkiake Nr.5 , Rr. "Abdyl Frasheri", Pall.16, Shk.2, Ap.15.hoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Ilir Zeka

Ngritja e nje aktiviteti tregtar e sherbimesh riparimi per perfaqesimin Ekskluziv te firmes "HYUNDAI" ne Shqiperi.

Importimit te automjeteve te markes HYUNDAI dhe te gjitha markave te tjera.
Shitjes me shumice e pakice te automjeteve te markes "HYUNDAI" si dhe te gjitha markave te tjera.

Organizimit te sherbimit te servisit universal per te gjitha markat e automjeteve
Shitjes me shumice e pakice te pjeseve te kembimit, nyjeve, agregateve te automjeteve te te gjitha markave.

Kryerjes se servisit universal per te gjitha llojet e automjeteve te firmes "HYUNDAI" apo dhe te markave te tjera.

Kryerjes te te gjitha sherbimeve te tjera ndihmese e te nevojshme qe plotesojne kryerjen e aktivitetit ne fjale dhe qe nuk bien ndesh me ligjet shqiptare ne fuqi.

Qiradhenie e automjeteve te te gjitha llojeve; Ngritja e rrjetit te qiradhenies se automjeteve ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise; Dhenia e automjeteve te te gjitha llojeve me qira financiare (leasing). Ofrim sherbim taksie.

Import-Export te produkteve gjithfaresh (paisje elektro-shtepiake, produkte elektrike,.....e te tjera), *W. llogarit nga ligji i jeh shpallur te*

Organizimin e nje rrjeti njesish tregtare dhe riparuese te cilat do ushtrojne veprimtarine e tyre ne perputhje me veprimtarine kryesore, ne emer dhe per llogari te "HYUNDAI AUTO ALBANIA" SHPK.

Organizimin e panairove dhe ekspozitave per paraqitjen e automjeteve te te gjitha markave, berjen e publicitetit tregtar si dhe ruajtjen e ekskluzivitetit tregtar ne territorin e Republikes se Shqiperise te Grupit "HYUNDAI", ne bashkepunim te ngushte e ne perputhje te plote me kerkesat e tij.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqiptar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 lekë dhe eshte i ndare në 100 pjesë të barabarta, vlere nominale e të cilave eshte 1000 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqerise perkatesisht :

Ilir ZEKA 'kuota me vlere te pergjithshme 100.000 Leke, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Ilir Zeqa 

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetem në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakut të Vetem të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të Vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku i Vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,

Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

Ali Leka 

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortakut i vetem.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Zyres se Regjistrimit Tregtar per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.



Neni 11

Administrimi

Administratore e shoqerise eshte znj. Z. Etleva LARO, e bija e Minait dhe e Antigonas, e dtl. 12 Korrik 1978, lindur ne Fier dhe banuese ne Tirane, Bulevardi " Zhan D' Ark ", Pallati i ri mbas ATSH - se, mandati i te ciles eshte 3 vjet..

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 12

Kompetencat

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marrëdhënie me te tretët ne emër te shoqërisë, ne te gjitha rrethanat me përjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë ne marrëdhëniet me te tretët nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr persiper pasojat ndaj te tretëve kur ajo provon se te tretët e dinin qe akti i

administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur te tretët nuk mund ta injoronin ketë akt ne rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretët.

Administratorit ose ortakut qe nuk jane persona juridike nuk u lejohet te kontraktojne ne çfarëdo forme qoftë, te marrin hua te shoqëria, te japin pelqimin ne emër te saj, per paradhënie si dhe te bëhen dorëzënës apo te garantojne ne emër te saj angazhimet ndaj te tretëve. Ne rast te kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 13

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj te tretëve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve te pamiratuara nga ortakut i vetem qe i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit qe ka bere marrëveshjen, per te perballuar ne menyre individuale pasojat perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakut ka te drejte te ngrene padi penale kundër administratorit

Ortakut ka te drejte te ndjeke ne rruge ligjore shlyerjen e plotë te demit qe i është shkaktuar shoqërisë, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese është e nevojshme.

Ortakut qe nuk eshte administrator, ka te drejte ne çdo kohe te informohet

Ilir Lekaj

personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogarët dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortaku i vetem, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë etj.

Neni 18

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tremeve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi, ortakut të vetem të shoqërisë.

Neni 19

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar sic mund të jenë :

Ilir Lela

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj. Ne një nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqërive Tregtare"

c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Ne këtë rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë. " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortaku i vetëm i shoqërisë, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërisë që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj të shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Regjistrimit Tregtar.

Neni 22

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vemendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecantë apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Ilir Lela

[Signature]

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare " *Hundai Auto Albania* " shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të ciles vertetohet nga Noteri.

ORTAKU

Ilir

ZEKA

Ilir Zeqa

